



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 24 shtator 2020
Nr. ref.:RK 1619/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI137/19

Parashtrues

Arlind Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit K. nr. 6-1022/18 të Gjykatës
Themelore në Pejë, të 18 korrikut 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Arlind Morina, nga fshati Grabanicë, komuna e Klinës, i cili përfaqësohet nga Sefer Desku, avokat nga Klina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin K. nr. 6-1022/18, të Gjykatës Themelore në Pejë – Divizioni për Kundërvajtje, të 18 korrikut 2018 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore). Parashtruesi i kërkesës po ashtu konteston veprimet e Policisë Regjionale në Pejë (në tekstin e mëtejme: Policia Regjionale) dhe Prokurorisë Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore), të cilët, sipas tij, nuk kanë iniciuar procedurë penale ndaj personit të tretë.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar dhe veprimeve të Policisë Regjionale dhe Prokurorisë Themelore, përmes të cilave parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 shtator 2019, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën ai e kishte dorëzuar në postë më 28 gusht 2019.
6. Më 10 shtator 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese) Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 23 shtator 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin që dëshmon se ai përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurat para Gjykatës.
8. Më 4 tetor 2019, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës autorizimin për përfaqësim, i cili ishte i pavlefshëm për Gjykatën Kushtetuese.
9. Më 17 tetor 2019, Gjykata sërish kërkoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin e vlefshëm, që dëshmon se ai përfaqëson parashtruesin e kërkesës në procedurat para Gjykatës.

10. Më 30 tetor 2019, Gjykata pranoi nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës autorizimin e kërkuar nga Gjykata.
11. Më 31 tetor 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës.
12. Më 2 shtator 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 29 qershor 2018, në rrugën “Eliot Engel” në Pejë, personi A. N., derisa po ngiste automjetin e saj, kishte goditur parashtruesin e kërkesës në pjesën e majtë të trupit, duke i shkaktuar lëndime trupore.
14. Më 12 korrik 2018, Stacioni Policorë i Trafikut në Pejë, kishte paraqitur në Gjykatën Themelore kërkesën DRO3004-396-18, për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër personit A. N., duke kërkuar që e njëjta të shpallet përgjegjëse dhe të dënohet për aksident trafiku, sipas dispozitave ligjore nga neni 149 [Detyrimet e shoferëve ndaj këmbësorëve], paragrafi 1, i Ligjit nr. 05/l-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor (në tekstin e mëtejme: Ligji për Trafikun Rrugor).
15. Më 18 korrik 2018, personi A. N., ishte paraqitur në Gjykatën Themelore dhe kishte pranuar kundërvajtjen me të cilën ngarkohej.
16. Po atë ditë, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit K. nr. 06-1022/18, shpalli përgjegjëse për kundërvajtjen personin A. N., sipas nenit 149 [Detyrimet e shoferëve ndaj këmbësorëve], paragrafi 1, të Ligjit për Trafikun Rrugor dhe e dënoi me gjobë në shumë prej 200.00 euro (dyqind). Në këshillën juridike të Aktgjykimit të sipërcekur, theksohej se: *“Kundër këtij aktgjykimi parashtruesi i kërkesës [që në rastin konkret ishte Stacioni Policor i Trafikut në Pejë] ka të drejtë ankese, në Gjykatën e Apelit – Divizioni për Kundërvajtje në Prishtinë, përmes të kësaj gjykate në afat prej 8 ditësh pas marrjes së këtij aktgjykimi”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi i kërkesës pretendon para Gjykatës Kushtetuese se përmes vendimit të kontestuar dhe veprimeve të Policisë Regjionale dhe Prokurorisë Themelore, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
18. Lidhur me këtë, ai ankohet se Policia Regjionale, Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore – Divizioni për Kundërvajtje *“në bashkëpunim mes veti, kanë shkelur të drejtën e [parashtruesit të kërkesës] në kualifikimin juridik të veprës penale ku njëkohësisht [personi A.N.] ka kryer veprën penale konform nenit 378 [Rreziku i trafikut publik]”* të Kodit Penal të Kosovës, nr. 04/L-82 (në tekstin e mëtejme: KPK). Andaj, ai thekson se ndaj personit A. N., është dashur të ngritët aktakuzë penale dhe të përgjigjet penalisht për lëndimet e rënda

trupore të shkaktuara parashtruesit të kërkesës. Ai thekson se si rezultat i këtyre lëndimeve ka mbetur “në gjendje të rëndë shëndetësore të pashërueshme”.

19. Parashtruesi thekson se Policia Regionale, Prokuroria Themelore kanë dërguar lëndën si kundërvajtje në Gjykatë, ku personi A. N., është dënuar me gjobë me qëllim që ajo të mos përgjigjet për vepër penale. Ai shton se shkelje ligjore ka bërë edhe Gjykata Themelore e cila e ka trajtuar këtë lëndë si kundërvajtje edhe pse nuk ka qenë kundërvajtje por vepër penale dhe se për shkak të këtyre veprimeve është shkelur e drejta e parashtruesit e garantuar me nenin 54 [Mbrojta Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.
20. Parashtruesi gjithashtu pretendon se Gjykata Themelore nuk e ka ftuar parashtruesin në seancë kur ka vendosur lidhur me kundërvajtjen ndaj personit A. N. dhe me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore nuk iu ka dhënë mundësia të ankohet.
21. Në fund, parashtruesi kërkon nga Gjykata që të anulojë Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore dhe të detyroj Prokurorinë Themelore që të ngrit aktakuzë për vepër penale ndaj personit A. N.

Dispozitat relevante ligjore

Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

“Neni 78

Kallëzimi penal nga organet publike

1. *Të gjitha organet publike detyrohen t'i paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat janë informuar ose për të cilat kanë marrë dijeni në ndonjë mënyrë tjetër.*

[...]

Neni 79

Kallëzimi penal nga personat

1. *Çdo person ka të drejtë të kallëzojë veprën penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe detyrohet ta bëjë këtë në rastin kur moskallëzimi i veprës penale paraqet vepër penale.*

[...]

Ligji Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje

“Neni 6

Kundërvajtjet dhe Veprat Penale

Kundër kryesit të kundërvajtjes, i cili në procedurë penale në formën e prerë është shpallë fajtorë për vepër penale e cila përfshinë edhe tipare të kundërvajtjes, nuk mund të zhvillohet procedura për kundërvajtje. Nëse procedura për kundërvajtje ka filluar apo është në rrjedhë, procedura nuk mund të vazhdohet dhe përfundohet.

[...]

Neni 73

I dëmtuari

1. Në kuptim të këtij ligji, i dëmtuar është personi të cilit i është shkelur ose rrezikuar me kundërvajtje ndonjë e drejtë personale ose pasurore.

2. I dëmtuari ka të drejtë që vetë ose nëpërmjet të përfaqësuesit ligjor ose të autorizuarit:

2.1. të paraqet dhe përfaqëson kërkesën, për fillimin e procedurës për kundërvajtje;

2.2. të paraqet prova, të bëjë propozime dhe të ushtrojë kërkesën pasurore juridike për kompensimin e dëmit ose për kthimin e sendit;

2.3. të paraqet ankesë kundër vendimit që është marrë lidhur me kërkesën e tij për fillimin e procedurës së kundërvajtjes;

2.4. të paraqes prova në bazë të të cilave gjykata mundet që të pandehurit t'i ndaloj që t'i ofrohet objektit të dëmtuar ose vendit të kryerjes së kundërvajtjes gjatë procedurës.

[...]

Neni 86

Paraqitja e kërkesave

1. Procedura e kundërvajtjes fillon në bazë të kërkesës së paraqitur për fillimin e procedurës së kundërvajtjes.

2. Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes mund ta paraqesin organet e autorizuara dhe i dëmtuari.

[...]

Neni 89

Hedhja poshtë e kërkesës

1. Kërkesa për fillimin e procedurës së kundërvajtjes do të hedhet poshtë me vendim, nëse konstaton se nuk ekzistojnë kushtet për fillimin e procedurës së kundërvajtjes si në vijim:

[...]

2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i dorëzohet paraqitësit të kërkesës, kurse do të informohet i dëmtuari se kërkesën pasurore - juridike mund ta realizojë në kontestin civil.

[...]

Neni 135

E drejta në ankesë

1. Kundër aktgjykimit dhe aktvendimit për kundërvajtjen, të marrë në shkallën e parë, mund t'i paraqitet ankesa Gjykatës së Apelit (më tej: gjykata e shkallës së dytë).

2. Kundër aktgjykimit për kundërvajtjen me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës, ankesën mund ta paraqes i pandehuri ose paraqitësi i kërkesës. [...].

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afati] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...]”.

25. Gjykata shqyrton gjithashtu nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], gjegjësisht paragrafin (1) (a) dhe (b) të Rregullores së punës, që përcaktojnë si në vijim:

Rregulli 39 i Rregullores së punës

[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar;

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjyimit ose vendimit të kontestuar;

[...]”.

26. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht sqaron se parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 18 korrikut 2018, si dhe faktin që Gjykata Themelore, Policia Regjionale dhe Prokuroria Themelore nuk kanë trajtuar veprimet e personit A. N., që i kishte shkaktuar parashtruesit të kërkesës lëndime trupore me veturën e saj, si vepër penale por si kundërvajtje. Andaj, parashtruesi pretendon se si pasojë e kësaj atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 54 [Mbrotja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Lidhur me Aktgjykim K. nr. 6-1022/18 të Gjykatës Themelore

27. Lidhur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore K. nr. 6-1022/18, që kishte dënuar personin A. N., me kundërvajtje, Gjykata fillimisht do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar për të kontestuar Aktgjykimin e lartcekur.
28. Gjykata thekson se kjo procedurë ishte iniciuar nga Stacioni Policorë i Trafikut në Pejë, përmes kërkesës DR03004-396-18, kundër personit A. N., duke kërkuar që e njëjta të shpallet përgjegjëse për kundërvajtje dhe të dënohet për aksident trafiku sipas dispozitave ligjore nga neni 149 [Detyrimet e shoferëve ndaj këmbësorëve], paragrafi 1, i Ligjit për Trafikun Rrugor. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit K. nr. 06-1022/18 shpalli përgjegjëse personin A. N., për kundërvajtjen, sipas nenit 149 [Detyrimet e shoferëve ndaj këmbësorëve], paragrafi 1, të Ligjit për Trafikun Rrugor dhe e dënoi me gjobë në shumë prej 200.00 euro.
29. Lidhur me këtë, parashtruesi thekson se Gjykata Themelore nuk ka vlerësuar veprimet e personit A. N., si vepër penale por si kundërvajtje, përkundër faktit që personi A. N., me veprimet e saj ka kryer vepër penale. Për më tepër, parashtruesi thekson se me vonesë ka marrë dijeni për Aktgjykimin e sipërcekur dhe nuk është njoftuar nga Gjykata Themelore në mënyrë që të ketë mundësi të paraqes ankesë.
30. Gjykata vëren se në këtë procedurë, Gjykata Themelore nuk ka vlerësuar nëse personi A. N., ka kryer vepër penale apo jo, pasi kryerja e veprës penale nuk ka qenë objekt shqyrtimi i kësaj procedure. Gjykata Themelore–Divizioni për Kundërvajtje, vetëm ka vlerësuar nëse personi A. N., ka kryer kundërvajtje sipas ligjit të sipërcekur dhe për këtë ka shpallur personin A. N. përgjegjës për kundërvajtje.

31. Në këtë aspekt, sipas paragrafit 3 dhe 4 të nenit 86 [Paraqitja e kërkesave] të Ligjit për Kundërvajtje, *“Procedura e kundërvajtjes fillon në bazë të kërkesës së paraqitur për fillimin e procedurës së kundërvajtjes”*. Ndërsa, *“Kërkesën për fillimin e procedurës së kundërvajtjes mund ta paraqesin organet e autorizuar dhe i dëmtuari”*.
32. Ndërsa, sipas nenit 135 [E drejta në ankesë] të Ligjit për Kundërvajtje, *“Kundër aktgjykimin për kundërvajtjen me të cilin i pandehuri shpallet përgjegjës, ankesën mund ta paraqes i pandehuri ose paraqitësi i kërkesës”*.
33. Parashtruesi i kërkesës në këtë rast nuk ishte njoftuar nga Gjykata Themelore se ai mund të paraqes ankesë ndaj Aktgjykimin të Gjykatës Themelore pasi ai nuk kishte iniciuar procedurën kundërvajtëse, por procedura ishte iniciuar nga Policia e Trafikut Rrugor në Pejë. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë palë në këtë procedurë dhe Gjykata Themelore nuk ka qenë e detyruar sipas ligjit që të njoftojë për një gjë të tillë parashtruesin e kërkesës.
34. Sipas nenit 89 [Hedhja poshtë e kërkesës] të Ligjit për Kundërvajtje, Gjykata Themelore ka për obligim ta njoftojë të dëmtuarin në rast se ajo hedhë poshtë kërkesën në mënyrë që të njoftohet i dëmtuari se kërkesën pasurore - juridike mund ta realizojë në kontestin civil. Në rastin konkret, Gjykata Themelore ka shpallur përgjegjës personin A. N. për kundërvajtje dhe ka dënuar të njëjtën me gjobë dhe në këtë procedurë parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë palë pasi kërkesa nuk është iniciuar nga parashtruesi i kërkesës.
35. Gjykata thekson se e vetmja çështje që ka pasur mundësi të prek të drejtat e parashtruesit të kërkesës në këtë rast ka qenë kërkesa e tij pasurore-juridike, e cila nuk ka qenë objekt i shqyrtimit para Gjykatës Themelore. Parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi që lidhur me kërkesën pasurore-juridike të filloj procedurë gjegjësisht kontest civil para gjykatave të rregullta, duke përfshirë mbi bazën e shpalljes përgjegjëse të personit A. N., përmes vendimit të kontestuar të Gjykatës Themelore.
36. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ankohet para Gjykatës lidhur me kërkesën pasurore-juridike si rezultat i aksidentit të shkaktuar nga personi A. N. dhe nuk ngritë ndonjë pretendim lidhur me këtë por ankohet për kualifikimin juridik të kundërvajtjes të bërë nga Gjykata Themelore kundër personit A. N.
37. Andaj, në kushtet kur kërkesa është parashtruar nga një palë e paautorizuar, Gjykata nuk mund të vlerësojë meritat e rastit dhe rrjedhimisht, as në rastin konkret, Gjykata nuk vlerëson pretendimet e parashtruesit nëse gjatë zhvillimit të procedurës kundërvajtjes të filluar sipas kërkesës së Policisë Rrugore, kundër personit A. N., janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës.
38. Rrjedhimisht, nga arsyet e lartpërmendura, Gjykata konstaton se kërkesa për vlerësimin e kushtetushmërisë së Aktgjykimin K. nr. 6-1022/18, të Gjykatës Themelore, nuk është paraqitur nga një palë e autorizuar siç përcaktohet me nenin 113, paragrafi 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit, rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

Lidhur me inicimin e procedurës penale ndaj personit A. N.

39. Sa i përket inicimit të procedurës penale ndaj personit A. N., parashtuesi konteston veprimet e Policisë Regjionale dhe rrjedhimisht Prokurorisë Themelore që nuk ka ngritur aktakuzë ndaj personit A. N., duke i ndërlidhur me pretendimin se si rezultat i lëndimit të parashtuesit personi A. N., ka kryer veprën penale nga neni 378 [Rreziku i trafikut publik], të KPK-së.
40. Lidhur me këtë, Gjykata para se të vlerësojë kriteret e tjera të pranueshmërisë, fillimisht do të vlerësojë nëse parashtuesi konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike, si dhe nëse ka shtetur mjetet juridike të parapara me ligj për të mbrojtur të drejtat e tij të parapara me Kushtetutë.
41. Gjykata thekson në këtë aspekt se procedura penale fillon me paraqitjen e kallëzimit penal nga palët e autorizuar. Në këtë rast, sipas nenit 78 të KPPK-së, kallëzimi penal bëhet nga organet publike, por sipas nenit 79 të KPPK-së “*çdo person ka të drejtë të kallëzojë veprën penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare [...]*”.
42. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës nuk konteston ndonjë akt konkret qoftë të Policisë Rajonale qoftë të Prokurorisë Themelore, me të cilën është hedhur poshtë kallëzimi penal apo janë mbyllur hetimet nga Prokuroria Themelore.
43. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës, përveç disa raporteve mjekësore nuk ka paraqitur asnjë dëshmi para gjykatës me të cilën vërteton se ai ka paraqitur kallëzim penal ndaj personit A. N., me të cilën do të iniciohej procedura për veprë penale ndaj personit A. N. Gjithashtu, ai nuk ka iniciuar asnjë procedurë ndaj Policisë Regjionale apo Prokurorisë Themelore, për faktin që ato nuk kanë iniciuar procedurën penale ndaj personit A. N.
44. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion, në pajtim me ligjin, kundër një vendimi apo veprimi të autoriteteve publike.
45. Në këtë mënyrë, autoriteteve publike duke përfshirë gjykatat e rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t’u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Aksoy kundër Turqisë*, Aktgjykimi i 18 dhjetorit 1996, paragrafi 51).
46. Parimi i shterjes së mjeteve juridike nënkupton që mekanizmi për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih,

mutatis mutandis, rastin e GJEDNJ-së *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 7 dhjetorit 1976, paragrafi 48).

47. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë mjete juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme që sigurojnë një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së *Vernillo kundër Francës*, Aktgjykim i 20 shkurtit 1991, paragrafi 27, dhe *Dalia kundër Francës*, Aktgjykim i GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998, paragrafi 38).
48. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjeti juridik në dispozicion ishte efektiv, në teori dhe praktikë, në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, *mutatis mutandis*, *Civet kundër Francës* paragrafët 42-44 të Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
49. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjeti juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike.
50. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi që ai ka ndërmarrë ndonjë veprim për të bërë kallëzim penal ndaj personit A. N., apo nëse lidhur veprimet apo mosveprimet e Policisë Regjionale dhe Prokurorisë Themelore që ka të bëjë me akuzën e mundshme penale ndaj personit A. N. kishte ndërmarrë ndonjë veprim ligjor. Andaj, Gjykata vlerëson se kjo pjesë e kërkesës të shpallet e papranueshme, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej përmes pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
51. Si përfundim, Gjykata vlerëson se sa i përket Aktgjykimit K. nr. 6-1022/18 të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të paraqitur kërkesë në Gjykatë, ndërsa sa i përket iniciimin e procedurës penale ndaj personit A. N. nga Policia Rajonale dhe Prokuroria Themelore, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur mjetet juridike të parapara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) dhe (b) të Rregullores së punës, më 2 shtator 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë


Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi